



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

### **V E N D I M** **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË** **MJEDISIT**

#### **Neni 1**

**z.Leutrim Krasniqi**, MSC i Gjeografisë, nga fshati Majac-Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

#### **Neni 2**

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:  
*Të emëruarit*  
*Zyrës së personelit*  
*Arkivit*

**Nr. 02-020/02-0008714/22**  
**Podujevë, 07 shkurt 2022**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 74 paragrafi 3.3 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/l-114, nenin 18.2 të Rregullores ( QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik dhe nenet 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR NËPUNËSIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK DHE MBËSHTETËS

#### Neni 1

Themelohet Komisioni i ankesave për nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës që kryejnë veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në kuadër të administratës Komunale, në këtë përbërje:

1. **Arianit Shaqiri**, udhëheqës i sektorit të gjendjes civile, kryesues
2. **Albertina Latifi**, zyrtare e personelit 2, anëtare
3. **Enis Sheholli**, zyrtar i lartë ligjor, anëtar

#### Neni 2

Komisioni ka mandat tre (3) vjeçar.

#### Neni 3

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik nr.06/L-114, Rregulloren (QRK) nr.11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publik dhe aktet tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0008314/21, datë 03 shkurt 2021.

*Me këtë Vendim njoftohen:*

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria e Administratës
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Nr.02-020/04-0009020/22  
Podujevë, 07 shkurt 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**Ismet Kadriu**, inxhinier në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Autorizohet për kryerjen e punëve dhe detyrave si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të Sektorëve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

#### Neni 2

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi më 08 shkurt 2022, dhe vlen deri në emërimin e pozitave sipas procedurave ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ.

#### Neni 4

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së udhëheqësit të Sektorëve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Nënshkrimi i të autorizuarit

#### Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.prot. 02-020/05-0040983/21 i datës 24 maj 2021

Me këtë vendim njoftohen:


I Autorizuari

DPUMM dhe Zyra e Personelit

Arkiva

Nr.prot.02-020/05-0009017/22  
Podujevë, 07 shkurt 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

1. Për hartimin e draft Rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoha të Komunës së Podujevës, ngritet Grupi punues në këtë përbërje:

1. **Fatlum Osmani**, Drejtorja e Buxhetit dhe Financave - UD drejtor, Koordinator i Grupit
2. **Leotrim Krasniqi**, Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit anëtar
3. **Bahri Selimi**, Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - UD drejtor, anëtar
4. **Avni Fetahu**, Drejtorja e Arsimit - UD drejtor, anëtar
5. **Vigan Salihu**, Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - UD drejtor, anëtar
6. **Antoneta Ejupi**, Drejtorja e Administratës,- UD Drejtoreshë, anëtare
7. **Besnik Mulliqi**, Drejtorja e Inspeksionit,- UD Drejtor, anëtar

2. Zyra Ligjore, është pjesë përbërëse e Grupit punues gjatë procesit të hartimit të Draft Rregullores së cekur.

#### Neni 2


Drafti i Rregullores për taksa tarifa dhe gjoha të përgatitet në afatin optimal dhe i njëjti i prezantohet Zyrës së Kryetarit.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0009076/22  
Podujevë, 08 shkurt 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002690/22 të datës 13 janar 2022, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

### VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

#### Neni 1

Njëqindpesëdhjetedy (152) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare në shumë të përgjithshme 18,050.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

#### Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

#### Neni 4


Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.


#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0010457/22  
Podujevë, 11 shkurt 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulhqi





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Rregulloren nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Në funksion të krijimit të ndërmarrjes publike të Komunës së Podujevës, në fushën e shërbimeve publike, ngritet Grupi punues, në këtë përbërje:

<b>Marigona Lahu</b> , <i>Nënkryetare e Komunës</i>	<i>kryesuese</i>
<b>Bahri Selimi</b> , <i>U.D - Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit</i>	<i>anëtar</i>
<b>Fatlum Osmani</b> , <i>U.D - Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave</i>	<i>anëtar</i>
<b>Vigan Salihu</b> , <i>U.D - Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik</i>	<i>anëtar</i>
<b>Pajtim Balaj</b> , <i>U.D - Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit</i>	<i>anëtar</i>

#### **Neni 2**

Grupi punues do të bashkëpunojë dhe koordinojë të gjitha punët dhe aktivitetet me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike – NJPMNP dhe ndërmerr veprimet e nevojshme në funksion të themelimit të ndërmarrjes publike komunale në pajtim me Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Rregulloren nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

#### **Neni 3**

Për punën dhe aktivitetet e kryera Grupi punues informon Zyrën e Kryetarit në formë të shkruar.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-020/04-0010827/22**  
**Podujevë, 14 shkurt 2022**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Buliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-020/02-0011343/22, datë 16.02.2022, nxjerrë këtë;

### VENDIM

#### **PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT / ESHËS TË SHKOLLËS SË MESME TË LARTË EKONOMIKE - SHMLE "ISA BOLETINI" NË PODUJEVË**

##### **Neni 1**

**znj.Besarta Raçi**, nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimi \_\_\_\_\_, *Bachelor Teknologji Informatikë – UP, dhe MSC i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri - UBT,*

**Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtoreshës të SHMLE "Isa Boletini", në Podujevë.**

##### **Neni 2**

E përmendura sipas neni 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

##### **Neni 3**

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

##### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi i Kryetarit të Komunës nr.prot. 02-020/02-0103176/21, datë 23 nëntor 2021.

##### **Neni 5**

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*I dërgohet:  
Drejtoria e Arsimit  
Të emëruarës  
Arkiv*

**Nr. 02-020/02-0011590/22  
Podujevë, 16 shkurt 2022**

**Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-020/02-0011343/22 , datë 16.02.2022, nxjerrë këtë;

### VENDIM

#### PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E ZËVENDËS DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË LARTË EKONOMIKE - SHMLE "ISA BOLETINI" NË PODUJEVË

##### Neni 1

**z. Muhamed Sejdiu**, nga fshati Obrançë, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit \_\_\_\_\_, *MSC i Shkencave Ekonomike* – Kolegji i Menaxhmentit Internacional,

**Emërohet përkohësisht në pozitën e Zëvendës Drejtorit të SHMLE "Isa Boletini", në Podujevë.**

##### Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

##### Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

##### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

##### Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*I dërgohet:*  
*Drejtorisë së Arsimit*  
*Të emëruarit*  
*Arkivit*

**Nr. 02-020/02-0011591/22**  
**Podujevë, 16 shkurt 2022**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpirtim Buhliqi**

